



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2021:181142
Datë: 21.01.2026
Numri i dokumentit: 08343501

K.DH.SH.II.nr.1378/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Dren Rogova dhe Vlora Rexhepi Pacolli, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit “në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “T7” Sh.P.K., me NRB:810104167, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arianit Koci dhe Granit Vokshi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Komisioni i Pavarur për Media, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Arta Zejnullahu Sadiku, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1030/24/, të datës 28.04.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.01.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komisioni i Pavarur për Media, me seli në Prishtinë.

II.VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1030/24/, të datës 28.04.2025.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar KA.nr.424/24/22, të datës 02.09.2024, ka vendosur si në vijim: Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “T7” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, për shkak të heshtjes administrative, kundër të paditurit Komisioni i Pavarur për Media. OBLIGOHET i padituri Komisioni i Pavarur për Media, që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 28.06.2021, të paraqitur nga paditësi “T7” Sh.P.K., dhe vendimin t`ia dorëzojë paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Shtyrja e ekzekutimit të Vendimit nr.ref.2015/635/KPM/xhl, të datës 27.05.2021, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Media, sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1858/2021 i datës 14.09.2021, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit, të anulohet aktgjykimi i atakuar dhe të mbetet në fuqi vendimin Nr.Ref.2105/635/KPM/xhl, të datës 27.05.2021 i Komisionit të Pavarur të mediave.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet të shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa-bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Paditësi “T7” Sh.P.K., përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi për shkak të heshtjes administrative ndaj të paditurit Komisioni i Pavarur për Media, me seli në Prishtinë, me propozimin për shtyrje të ekzekutimit. Në padi ndër të tjerash ka theksuar se i padituri me qëllim që mediat të veprojnë në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje me datë 26.01.2021, përmes postës elektronike i ka dërguar ofruesve të shërbimeve mediale audio vizuale Ditarët A dhe B (për terminët e reklamave të emetuara pa pagesë dhe me pagesë) dhe po ashtu edhe sqarimin për plotësimin e tyre. I padituri ka gjetur se paditësi ka dështuar ti sjellë Ditarët Vjetor A dhe B duke vepruar kështu në kundërshtim me Kreun VIII dhe me vendimin Nr.Ref.2105/635/KPM/xhl, të datës 27.05.2021, sipas të cilit ka sanksionuar paditësin në shumë prej 1,000.00 euro, ndaj të cilës paditësi ka parashtruar ankesë. I padituri me njoftimin e datës 28.07.2021, e ka njoftuar paditësin se Bordi i Ankesave të paditurit është në përbërje jo të plotë deri në zgjedhjen e anëtarit të katërt. Ka shtuar se paditësi çdo herë ka vepruar në përpikëri me Ligjin dhe Udhëzimet Ligjore, por këtë vit për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, dhe paditësi ka qenë duke punuar me staf esencial dhe për këtë arsye nuk ka arritur ti dërgoj në kohë Ditarët, e për këtë arsye me mirësjellje ka kërkuar nga bordi i ankesave që ti caktoj një afat shtesë prej 5 ditëve. Me parashtrësën e datës 14.09.2021, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që ka kërkuar që të aprovohet si e themeltë padia dhe kërkesëpadia e paditësit, të obligohet i padituri që të merr vendim me të cilin të aprovoj ankesën e paditësit të datës 28.06.2021, ashtu që të anulohet Vendimi Nr.Ref.2105/635/KPM/xhl i datës 27.05.2021 dhe Njoftimi Nr.Ref.2107/843/BA/yf, të paditurit.

I padituri me përgjigje në padi ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ndër të tjerash ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit pasi që i padituri me kohë e ka njoftuar për respektimin e Ligjit për Zgjedhjet. Ka shtuar se Vendimi i të paditurit Nr.Ref.2105/635/KPM/xhl, është vendim përfundimtar, i ekzekutueshëm dhe i formës së prerë, dhe se sikur Bordi i Ankesave të ishte funksional do ta trajtonte ankesën e paditësit dhe do të vendoste në afatin e paraparë, mirëpo në mungesë të tij paditësi e ka vazhduar procedurën në gjykatë. Ka theksuar se Vendimi i të paditurit është marr në bazë të autorizimeve ligjore dhe në përputhje të plotë me Ligjin e KPM-së dhe aktet nënligjore. I ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet si e pa themeltë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, me aktgjykimin ankimuar e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje lenden teke paditura (si në dispozitiv të këtij aktgjykimit). Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ndër tjerash ka konstatuar se: Nga provat e administruara në këtë çështje, gjykata i vlerësoi si të bazuara pretendimet e paditësit lidhur me heshtjen administrative, pasi që i padituri nuk ka vendosur për ankesën e parashtruar nga paditësi. Neni 14 i Ligjit për Konflikt Administrativ përcakton se: *“Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.”* Andaj, sipas nenit 124 par. 6 pika 6.1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se *“6. Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përgjithshëm, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në keto raste: 6.1. nuk ekziston organi epror.”* Sipas nenit 127 par. 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.”* Nga dispozita e lartcekur, gjykata konstaton se paditësi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesën e datës 28.06.2021, ndërsa i padituri duke mos vendosur ka rënë në heshtje administrative në kundërshtim me afatet e cituara më lartë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykim, bazuar në neni 46 par. 6 të LKA-së i cili përcakton se: *“Kur padia është paraqitur në bazë të nenit 29 të këtij ligji, ndërsa gjykata konstaton se është e arsyeshme, do ta aprovojë padinë me aktgjykim dhe do të caktojë organin kompetent të nxjerrë vendimin”*, andaj gjykata vendosi që të obligojë të paditurin Komisioni i Pavarur për Media, me seli në Prishtinë, që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, të vendos lidhur me ankesën e datës 28.06.2021, të paraqitur nga paditësi ndaj vendimit Nr.Ref.2105/635/KPM/xhl, datës 27.05.2021 si dhe vendimin lidhur me këtë ankesë të ia dorëzojë paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Dytë e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimin i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar pretendimet në padi, në drejtim të thënieve në padi, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar padinë e paditësit dhe ka obliguar të paditurin, që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 28.06.2021, të paraqitur nga paditësi “T7” Sh.P.K., dhe vendimin të ia dorëzojë paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, ka shqyrtuar pretendimet ankimore paditurës por nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara. Aktgjykimin i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm për faktet vendimtare, të cilat i

pranon edhe kjo gjykatë. Në ankesën e paraqitur, e paditura nuk ka arritur të paraqesë argumente të kundërta ndaj atyre që i ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë. Këto shpjegime janë në përputhje me dispozitat ligjore, ndërsa me të drejtë është aprovuar si të bazuara pretendimet e paditësit lidhur me heshtjen administrative, pasi që i padituri nuk ka vendosur për ankesën e parashtruar nga paditësi. Neni 14 i Ligjit për Konflikt Administrativ përcakton se: *“Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.”* Ndërsa sipas nenit 124 par. 6 pika 6.1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se *“6. Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përgjithimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në keto raste: 6.1. nuk ekziston organi epror.”* Neni 127 par. 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.”* Edhe kolegji i kësaj gjykate pajtohet me qëndrimet faktike dhe juridike të gjykatës e shkallës së parë se paditësi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesën e datës 28.06.2021, ndërsa i padituri duke mos vendosur ka rënë në heshtje administrative në kundërshtim me afatet e cituara më lartë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje të konstatuar, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, nga shkak se e paditura me asnjë provë nuk e ka vërtetuar një gjendje të tillë të krijuar për mos mundësinë e vendosjes ashtu siç me dispozitat e neneve të lartcekura të LPA-së, meqë gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka vlerësuar se paditësi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesën e datës 28.06.2021, ndërsa i padituri duke mos vendosur ka rënë në heshtje administrative dhe nuk ka vendosur brenda afateve të përcaktuara me ligje.

Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për, ky kolegji nuk i aprovoi sepse vlerësoi se janë të pabazuara dhe pa ndikim në vërtetimin e gjendjes faktike nga ajo e vetëtuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, për shkak se e paditura nuk ka vendosur brenda fateve ligjore të përcaktuara me ligj, dhe si rezultat i kësaj i ka mohuar paditësit shqyrtimin e ankesës në procedure administrative. Andaj, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Duke marr parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, me të cilin e ka obliguar të paditurin Komisioni i Pavarur për Media, që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të vendosë lidhur me ankesën e paditësit të datës 28.06.2021, të paraqitur nga paditësi “T7” Sh.P.K., dhe vendimin të ia dorëzojë paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitat ligjore të neni 46 par. 6 të LKA-së i cili përcakton se: *“Kur padia është paraqitur në bazë të nenit 29 të këtij ligji, ndërsa gjykata konstaton se është e arsyeshme, do ta aprovojë padinë me aktgjykim dhe do të caktojë organin kompetent të nxjerrë vendimin”,* andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur që të obligojë të paditurin Komisioni i Pavarur për Media, me seli në Prishtinë, që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të vendosë lidhur me

ankesën e datës 28.06.2021, të paraqitur nga paditësi ndaj vendimit Nr.Ref.2105/635/KPM/xhl, datës 27.05.2021 si dhe vendimin lidhur me këtë ankesë të ia dorëzojë paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Kolegji vlerëson gjykata e shkallës së parë përfundimin e tërë kësaj procedure e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme dhe se mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Përfundimisht, Gjykata e Komerciale e Kosovës i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1378/25, me datë 15.01.2026

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi d.v.